HEI'25
Higher Education Intervention 2025

ORCA
organizata për rritjen e cilësisë në arsim

TRANSPARENCA FINANCIARE E UNIVERSITETEVE PUBLIKE 2024



Publikues:
ORCA – Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim
orca-ks.org
info@orca-ks.org
Henrik Bariç, Nr. 6

Hartuese e raportit:
Fellona Feta

Hulumtuese:
Fellona Feta

Redaktor i përmbajtjes:
Rron Gjinovci

Prishtinë, Gusht 2025

"Ati ynë që je në qiell, jepna fuqinë ta mbajmë gojën mbyllur kur s'kemi gjë për të thënë. Falna durimin të thellojmë një punë përpara se të shkruajmë mbi të! Frymëzona me një ndjenjë të mprehtë të drejtësisë që të flasim jo vetëm me paanësi, por edhe të sillemi ashtu! Shpëtona nga grackat e gramatikës, nga shtrembërimet e gjuhës dhe nga lajthitjet e shtypit.
Ashtu qoftë!"

Faik Konica

Përmbajtja

5 Përmbledhje Ekzekutive

6 Buxheti për universitete publike 2024

7 Rënia e shtesave në universitete publike përgjatë viteve
8 Kursimet në shtesat e stafit menaxherial përgjatë viteve

10 Mesataret e të ardhurave dhe shtesave për stafin akademik menaxherial në 2024
13 Krahasimi i të ardhurave të stafit menaxherial ndërmjet universiteteve publike
14 Problemet përgjatë analizave të deklarimeve nga stafi akademik menaxherial

16 Gjetjet për secilin universitet
16 Universiteti i Prishtinës
21 Universiteti i Pejës
26 Universiteti i Gjilanit
31 Universiteti i Prizrenit
36 Universiteti i Gjakovës
41 Universiteti i Mitrovicës
46 Universiteti i Ferizajt

52 Metodologjia

Përmbledhje Ekzekutive

Të ardhurat e stafit akademik menaxherial dhe shtesat që ata i marrin mbi pagën bazë kanë pësuar rënie të vazhdueshme ndër vite. Në vitin 2019 të ardhurat për këtë kategori ishin mesatarisht 2,013 EUR në muaj, prej të cilave shtesa ishin mesatarisht 836 EUR. Në vitin 2024 të ardhurat janë 1610 EUR, ku 534 EUR është vlera mesatare e shtesave mujore.

Në vitin 2024, kategoria më e paguar nga stafi akademik menaxherial janë anëtarët e rektoratit si rektori dhe prorektorët me mesatarisht 1,738 EUR në muaj. Në vendin e fundit janë anëtarët e këshillit drejtues nga radhët e stafit akademik me mesatarisht 1,483 EUR në muaj. Ndërsa sa i përket shtesave, kategoria më e paguar nga stafi akademik menaxherial janë po ashtu anëtarët e rektoratit si rektori dhe prorektorët me mesatarisht 657 EUR ne muaj. Në vendin e fundit janë prodekanët me mesatarisht 462 EUR në muaj.

Në vitin 2019 shtesat e përbënin 42% të të ardhurave mesatare të stafit menaxherial akademik në universitete publike, ndërsa në vitin 2024 kjo mesatare është 33% e të ardhurave mesatare. Për më tepër tanimë kjo gjë është rregulluar me Ligjin e Punës dhe tejkalimi i pagës deri në 30% konsiderohet i ligjshëm në Kosovë.

Dallimi më i vogël në të ardhurat mes kategorive të stafit menaxherial si anëtarët e këshilleve drejtuese, rektorët dhe prorektorët, dekanët dhe prodekanët, mbetet ai i vitit 2023. Nëse në vitin 2020 dallimi mes kategorisë më të paguar dhe asaj më pak të paguar ishte 924 EUR, në vitin 2023 ky dallim ishte 169 EUR. Në vitin 2024 ky dallim është 255 EUR.

Në vitin 2024 të ardhurat mesatare më të larta kishte Universiteti i Pejës me shumën 1,789 EUR në muaj, ndërkaq të ardhurat mesatare më të ulëta kishe Universiteti i Mitrovicës me 1,538 EUR në muaj. Universiteti i Pejës kishte po ashtu shtesat më të larta me mesatarisht 701 EUR në muaj, ndërkaq Universiteti i Gjilanit kishte shtesat mesatare më të ulëta me 455 EUR në muaj.

Zyrtarët e projektit HEI'25 kanë llogaritur shumën totale të kursimeve që janë bërë përmes uljes së shumës për shtesa përgjatë viteve. Është vërejtur se si pasojë e kritikës sistematike publike shuma e shtesave ka qenë vazhdimisht në rënie që nga viti 2019 kur projekti paraardhës QAINT i projektit aktual HEI'25 ka filluar këtë matje për herë të parë, kjo shumë e akumuluar në gjashtë vite është 1,869,633 EUR.

Buxheti për universitetet publike i vitit 2024

Buxheti total i universiteteve publike në Kosovë në vitin 2024 ishte 50,172,146.00 EUR. 96%, ose saktësisht 48,182,680.00 EUR janë ndarë nga buxheti i Kosovës, që do të thotë taksapaguesi i cili nuk është i regjistruar si student, paguan pothuajse tërë faturën e arsimit të lartë publik në Kosovë.

58% e buxhetit të universiteteve publike ka shkuar në paga dhe mëditje, 14% në mallra dhe shërbime, 3% në shpenzime komunale, 6% në subvencione dhe transfere, dhe 19% në shpenzime kapitale.

Linja buxhetore	Buxheti 2024
Paga dhe mëditje	29,096,128 €
Mallra dhe Shërbime	6,912,410 €
Shpenzime komunale	1,629,608 €
Subvencione dhe Transfere	2,844,000 €
Shpenzime Kapitale	9,690,000 €
Totali	**50,172,146 €**

Universiteti i Prishtinës edhe në 2024 e pati buxhetin më të madh me rreth 63% të totalit të buxhetit për arsim të lartë publik. Universiteti i Pejës pasoi i dyti me 9%, i Mitrovicës dhe Gjakovës me 7%. Vazhdoi me 6% Universiteti i Prizrenit dhe me nga 4% të totalit ishin Universiteti i Ferizajt dhe i Gjilanit.

Universiteti	Buxheti 2024
Universiteti i Gjakovës	3,309,059
Universiteti i Mitrovicës	3,567,551
Universiteti i Ferizajt	2,113,535
Universiteti i Gjilanit	2,034,656
Universiteti i Prishtinës	31,710,072
Universiteti i Pejës	4,470,652
Universiteti i Prizrenit	2,966,621
Totali	**50,172,146**

Rënia e shtesave në universitete publike përgjatë viteve


Në vitin 2024 të ardhurat e stafit akademik menaxherial të universiteteve publike ishin mesatarisht 1,610 EUR në muaj, që paraqet një rënie prej 224 EUR, apo rreth 12% më pak se në vitin 2023. Po ashtu, shtesat mesatare që ata i kanë marrë mbi pagën bazë ishin 534 EUR, ose rreth 5% më pak se në vitin 2023.

Shtesat dhe përqindja e tyre në të ardhura

Të hyrat ndër vite	Mesatarja e të ardhurave mujore	Mesatarja e shtesave mujore	Përqindja mesatare e shtesave në të ardhura
2019	2013	836	42%
2020	1916	696	36%
2021	1804	574	32%
2022	1874	606	32%
2023	1834	566	31%
2024	1610	534	33%

Nga matja e parë e ORCA-së në vitin 2019, të ardhurat mujore dhe shtesat e stafit akademik menaxherial kanë pësuar një rënie graduale. Shtesat mbi pagën bazë kanë rënë në mënyrë të vazhdueshme nga viti 2019 kur ishin mesatarisht 836 EUR, në 534 EUR në vitin 2024. Përkthyer në përqindje, i bie që shtesat në vitin 2019 përbënin 42% të të ardhurave të stafit akademik menaxherial ndërkaq në vitin 2024 ato kanë rënë në 33%.


Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në universitete publike ndër vite




Kursimet në shtesat e stafit menaxherial përgjatë viteve si pasojë e kritikës sistematike për to

Projekti HEI25 dhe komponenta e monitorimit të financave publike të universiteteve është vazhdimësi e atij të projektit QAINT i cili po ashtu u financua nga ADA. Përmes një llogaritje, ku nga shpenzimet për shtesat e të ardhurave të stafit menaxherial të universiteteve publike ishin në kulm me një vlerë prej 1,498,258 EUR, zbriteshin vlerat e viteve pasardhëse të cilat në vazhdimësi kanë qenë në rënie, del se kritika publike dhe periodike e projekteve QAINT dhe HEI25 ka bërë që publikut kosovar t'i kursehen 1,869,633 EUR.

Raporti mes shumës totale të shpenzimeve për shtesa dhe shumës së kursyer në secilin vit




Raporti mes kursimit të akumuluar ndër vite për shtesa dhe shumës së kursyer në secilin vit



Në grafikën me poshtë është paraqitur përqindja e tejkalimit të shtesave në raport me pagat e përcaktuara me ligj. Sasia e përqindjeve të tejkalimit të shtesave të lejuara me ligjin e ri për pagat në sektorin publik është paraqitur më poshtë bashkë me numrin e profesorëve që hyjnë në ato përqindje të tejkalimit të shtesave të lejuara me ligj.

Me të kuqe janë paraqitur përqindjet e tejkalimit të shtesave dhe numri i profesorëve që bëjnë pjesë në ato grupe përqindjesh, të cila nuk janë të lejuara me ligj. Ndërsa, me të kaltër janë paraqitur përqindjet e tejkalimit të shtesave dhe numri i profesorëve që bëjnë pjesë në ato grupe përqindjesh, të cilat janë të lejuara me ligj.


Përqindjet e lejuara dhe tejkaluara për shtesat e stafit menaxherial



Mesataret e të ardhurave dhe shtesave për stafin akademik menaxherial në 2024


Në vitin 2024 të ardhurat e stafit akademik menaxherial ishin mesatarisht 1,610 EUR, ndërsa mesatarja e shtesave të tjera të papërcaktuara me ligj (pa e llogaritur shtesën funksionale për pozitë menaxheriale, si ajo e rektorit, dekanit apo ndonjë pozite tjetër) ishte 380 EUR. Ndërsa po të merret për llogaritje edhe mesatarja e shtesave funksionale atëherë vlera mesatare e shtesave mbi pagat e përcaktuara me ligj është 534 EUR.

Mesataret e të ardhurave dhe shtesave për stafin akademik menaxherial në 2024




Sa i përket krahasimit ndërmjet viteve për pozitat e rektorit dhe prorektorit, në vitin 2024 është shënuar një rënie në mesataren e të ardhurave mujore prej 157 EUR krahasuar me vitin 2023. Po ashtu, mesatarja e shtesave mujore ka shënuar një rënie prej 210 EUR. Për pozitat e dekanit dhe prodekanit, gjithashtu është evidentuar një rënie prej 234 EUR në mesataren e të ardhurave mujore dhe një rënie prej 197 EUR në mesataren e shtesave mujore. Në grafikat më poshtë janë paraqitur mesataret e te ardhurave mujore dhe shtesave të stafit akademik menaxherial të universiteteve publike ndër vite.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit menaxherial të universiteteve publike ndër vite



Nga grafika e mësipërme vërehet se ka pasë një trend të rritjes së barazisë mes pagave të pozitave menaxheriale në universitete publike e cila ka kulmuar me Ligjin e ri duke i bërë praktikisht dallimet vetëm simbolike që shënojnë hierarkinë e pozitave.

Shtesat mesatare mujore të stafit menaxherial të universiteteve publike ndër vite




Na dy grafikat e mësipërme vërehet se dekanët si menaxherë të njësive akademike në çfarëdo periudhe kanë pasë një pozitë më të favorshme se pozitat tjera universitare përpos me rektorët. Ndonëse do të ishte e pritshme, parë nga një perspektivë hierarkike, që prorektorët të ishin menjëherë në radhë pas rektorëve për të ardhura më të mëdha apo edhe për shtesat që marrin, në fakt janë dekanët ata që kanë pasuar rektorët në të gjitha periudhat e matjeve.

Krahasimi i të ardhurave të stafit menaxherial ndërmjet universiteteve publike

Bazuar në deklarimet e pasurisë për vitin 2024, të ardhurat mesatare më të larta i kishte Universiteti i Pejës prej 1,789 EUR. Ndërsa sa i përket shtesave, ato ishin po ashtu më të lartat në Universitetin e Pejës me shtesa mesatare rreth 701 EUR, ndjekur nga Universiteti i Ferizajt me 609 EUR dhe ai i Prizrenit me 579 EUR, sa i përket shtesave më të ulëta kishte Universiteti i Gjilanit me 455 EUR shtesa mesatare në muaj. Në anën tjetër, pagat mesatare bazë më të ulëta janë deklaruar në Universitetin e Ferizajt me 1,006 EUR dhe në atë të Gjakovës me 1,041 EUR, ndërkaq pagë mesatare bazë më të lartë kishte Universiteti i Gjilanit me 1,092 EUR. Në grafikun e mëposhtëm mund të i shihni se si shpërndahen të ardhurat dhe shtesat ndër universitete.

Të ardhurat dhe shtesat mesatare te stafi akademik menaxherial në universitetet publike



Për këtë dallim mes Universitetit të Pejës dhe të tjerave një shpjegim i mundshëm është se menaxhmenti i këtij universiteti është në detyrë që para futjes së ligjit të ri në fuqi, çka e bën këtë Universitet t'i ekzekutojë pagat e stafit menaxherial me norma të periudhës transitore dhe jo sipas normave të ligjit aktual me të cilat shërbehen universitetet e tjera.

Problemet përgjatë analizave të deklarimeve nga stafi akademik menaxherial

Gjatë analizës vërehet se stafi akademik i universiteteve publike nuk e kanë një formë të ngjashme të deklarimit të pasurisë. Deklarimet janë të ndryshme dhe nuk përcjellin një logjikë deklarimi, çka e bëri shumë të vështirë deshifrimin e tyre. Pjesa më e madhe e stafit të ardhurat vjetore nga universiteti i kanë paraqitë në një shumë të vetme e cila ishte e paqartë për publikun. Më poshtë janë paraqitur të ardhurat e deklaruara sipas kategorizimeve që ka përdorë stafi akademik i universiteteve publike të Kosovës.

"Shtesat dhe kompensimet me vendim" janë një emërtim i paqartë qoftë për hulumtuesit e ORCA-s qoftë për publikun e megjithatë ato janë deklaruar nga stafi akademik i universiteteve publike. Numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 37 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 22% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Vendimet gjyqësore" ky kategorizim misterioz është problematik në deklarimin e të ardhurave. Nuk merret vesh se si vendimet gjyqësore sigurojnë të ardhura për stafin akademik. Nuk dihet natyra e këtyre vendimeve dhe hapësira për të manipuluar me deklarimin. Numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 6 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 4% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Procedura përmbarimore" po ashtu është një kategori misterioze e cila nuk qartëson si dhe për çfarë janë realizuar këto procedura përmbarimore. Numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 3 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 2% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Pagesa neto - punë jashtë orarit" **-** numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 18 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 11% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Mëditjet - brenda vendit" - numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 6 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 4% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Pagesat për përvojë të punës" - numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 4 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 2% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Publikimet" - numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 21 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 12% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Subvencione" - numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 18 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 11% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

"Konferencat" - numri i stafit akademik menaxherial të cilët i kanë deklaruar këto të ardhura është 5 nga 170 deklarime të cilat janë hulumtuar nga ORCA, që përfaqëson 3% të stafit që i ka deklaruar këto të ardhura.

Në përmbledhjen e shumave të tjera të deklaruara nga stafi akademik menaxherial me burim nga universitetet përkatëse janë: të ardhura nga projektet në kuadër të universitetit, punët me kontratë por jo në listën e pagave, të hyra nga angazhimet me projektet Erasmus+, pagesa për komisione, rimburësime për "staff costs" etj.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura numri i stafit që i ka deklaruar te ardhurat e mësipërme:

Kategorizimi i të ardhurave të stafit menaxherial	Numri i stafit menaxherial të deklaruar	Përqindja e stafit menaxherial të deklaruar	Shuma totale
Shtesa dhe kompensime me vendim	37	22%	79,886
Mëditjet - brenda vendit	6	4%	6,681
Mëditjet - jashtë vendit	41	24%	69,512
Pagesa neto - punë jashtë orarit	18	11%	37,276
Pagesa për përvojë të punës	4	2%	1,701
Publikime	21	12%	21,808
Subvencione	18	11%	71,196
Konferenca	5	3%	5,200
Vendime gjyqësore	6	4%	10,824
Procedurat përmbarimore	3	2%	7,028
Shuma të tjera	30	18%	121,941

Gjetjet për secilin universitet

Universiteti i Prishtinës

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Prishtinës

Buxheti i Universitetit të Prishtinës në vitin 2024 ishte 31,710,072 EUR, i ndarë 62% në paga dhe mëditje, 12% në mallra dhe shërbime, 4% në shpenzime komunale, 5% në subvencione dhe grante dhe 17% në shpenzime kapitale. 95% i buxhetit të Universitetit të Prishtinës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 5% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare. Universiteti i Prishtinës në vitin 2024 ka pasur një ulje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 1 milion e 461 mijë e 510 EUR më pak në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	18,604,884	70%
	2020	18,327,239	59%
	2021	18,432,170	69%
	2022	20,596,599	66%
	2023	20,702,582	66%
	2024	**18,983,662**	**63%**
Mallra dhe shërbime	2019	3,164,086	12%
	2020	3,183,954	10%
	2021	3,063,822	11%
	2022	2,765,745	9%
	2023	2,950,000	10%
	2024	**3,512,410**	**12%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	1,175,000	4%
	2020	1,175,000	4%
	2021	1,175,000	4%
	2022	1,170,000	4%
	2023	1,370,000	4%
	2024	**1,170,000**	**4%**
Subvencione dhe grante	2019	343,782	1%
	2020	343,782	1%
	2021	343,782	1%
	2022	1,044,000	3%
	2023	1,044,000	3%
	2024	**939,000**	**3%**
Shpenzime kapitale	2019	3,500,000	13%
	2020	7,900,001	26%
	2021	4,000,000	15%
	2022	5,400,000	17%
	2023	5,400,000	17%
	2024	**5,400,000**	**18%**
Totali nga taksapaguesi	2019	26,787,752	**100%**
	2020	30,929,976	
	2021	27,014,774	
	2022	30,976,344	
	2023	31,466,582	
	2024	**30,005,072**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Prishtinës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët, anëtarët e Këshillit Drejtues.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prishtinës ndër vite




Bazuar në deklaratat e pasurisë për vitet 2023 dhe 2024, të ardhurat mujore të stafit akademik menaxherial në universitetet publike kanë shënuar një rënie të theksuar. Në vitin 2023, të ardhurat mesatare mujore ishin 2,026 EUR, ndërsa në vitin 2024 kjo shumë ka rënë në 1,593 EUR, që përfaqëson një ulje prej 433 EUR, apo rreth 21% më pak. Edhe shtesat mujore kanë pësuar rënie, duke zbritur nga 748 EUR në 509 EUR, që paraqet një diferencë prej 239 EUR, ose rreth 32% më pak krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2023, shtesat përbënin rreth 37% të pagës bazë mujore, ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje ka rënë në rreth 32%.

Kritika publike dhe të qenët në fokus të medieve gjatë gjithë kohës ka bërë që të rritet përgjegjshmëria e Universitetit të Prishtinës lidhur me kujdesin ndaj parasë publike.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prishtinës


Në Universitetin e Prishtinës uljen mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur më së shumti anëtarët e Rektoratit nga 2,100 EUR në vitin 2023, në 1,598 EUR në 2024. Ndërkaq uljen mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur anëtarët e KD-së që janë pjesë e stafit akademik, nga 1,934 EUR në vitin 2023, në 1,803 EUR në 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prishtinës ndër vite



Në Universitetin e Prishtinës, ngritje të madhe mesatare të shtesave kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 685 EUR në vitin 2023, në 814 EUR në 2024. Ndërkaq ulje mesatare të shtesave mujore kanë pasur anëtarët e Rektoratit nga 867 EUR në vitin 2023, në 516 EUR në 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prishtinës ndër vite



Në të gjitha kategoritë është evidentuar një zvogëlim i shtesave në krahasim me vitin 2023, përveç tek anëtarët e Këshillit Drejtues. Kjo për shkak se sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik, shtesa funksionale për Kryetarin e Këshillit Drejtues është e barabartë me 30% të pagës bazë të Zyrtarit më të Lartë Administrativ, që në rastin e universitetit është Sekretari i Përgjithshëm, ndërsa për anëtarët e Këshillit Drejtues është 20% e kësaj page. Për Kryetarin e Këshillit Drejtues kjo përfaqëson një rritje nga 250 EUR (siç ishte përcaktuar më parë me vendim të Ministrisë së Arsimit) në 412.5 EUR, ndërsa për anëtarët e Këshillit Drejtues nga 200 EUR në 275 EUR.

Universiteti i Pejës

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Pejës

Buxheti i Universitetit të Pejës në vitin 2024 ishte 4,470,652 EUR, i ndarë 45% në paga dhe mëditje, 13% në mallra dhe shërbime, 1% në shpenzime komunale, 4% në subvencione dhe grante dhe 36% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Pejës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet të financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Pejës në vitin 2024 ka pasur ngritje të buxhetit prej 111 mijë e 913 EUR në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	1,848,129	55%
	2020	1,727,717	46%
	2021	1,656,746	62%
	2022	2,272,717	65%
	2023	2,509,794	58%
	2024	**1,986,707**	**45%**
Mallra dhe shërbime	2019	412,007	12%
	2020	412,007	11%
	2021	500,000	19%
	2022	603,000	17%
	2023	603,000	14%
	2024	**603,000**	**14%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	50,408	1%
	2020	50,408	1%
	2021	50,408	2%
	2022	50,408	1%
	2023	50,408	1%
	2024	**50,408**	**1%**
Subvencione dhe grante	2019	100,000	3%
	2020	100,000	3%
	2021	100,000	4%
	2022	100,000	3%
	2023	100,000	2%
	2024	**185,000**	**4%**
Shpenzime kapitale	2019	970,000	29%
	2020	1,470,000	39%
	2021	350,000	13%
	2022	470,000	13%
	2023	1,070,000	25%
	2024	**1,620,000**	**36%**
Totali nga taksapaguesi	2019	3,380,544	**100%**
	2020	3,760,132	
	2021	2,657,154	
	2022	3,496,125	
	2023	4,333,202	
	2024	**4,445,115**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Pejës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët, anëtarët e Këshillit Drejtues.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës ndër vite




Në Universitetin e Pejës bazuar në deklarimet e pasurisë për vitet 2023 dhe 2024, të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Pejës kanë shënuar një rënie të konsiderueshme. Në vitin 2023, të ardhurat mesatare mujore ishin 1,998 EUR, ndërsa në 2024 ka rënë në 1,789 EUR, që përfaqëson një ulje prej 209 EUR, ose rreth 10% më pak. Edhe shtesat mujore nga 750 EUR në 701 EUR, që është një diferencë prej 49 EUR, ose rreth 7% më pak krahasuar me vitin paraprak.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Pejës


Në Universitetin e Pejës, uljen më të madhe mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur Prodekanët, nga 2,209 EUR në vitin 2023, në 1,660 EUR në 2024. Ndërsa uljen më të vogël mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur Rektori dhe Prorektorët, nga 2,329 EUR në vitin 2023, në 2,195 EUR në vitin 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Pejës ndër vite



Në Universitetin e Pejës ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 194 EUR në vitin 2023, në 483 EUR në vitin 2024. Ndërsa ulje më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur Prodekanët, nga 872 EUR në vitin 2023, në 416 EUR në vitin 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Pejës ndër vite



Universiteti i Gjilanit

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Gjilanit

Buxheti i Universitetit të Gjilanit në vitin 2024 ishte 2,312,204 EUR, i ndarë 55% në paga dhe mëditje, 23% në mallra dhe shërbime, 2% në shpenzime komunale, 9% në subvencione dhe grante dhe 10% në shpenzime kapitale.

94% i buxhetit të Universitetit të Gjilanit financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 6% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Gjilanit në vitin 2024 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 277 mijë e 548 EUR më pak në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	1,183,783	53%
	2020	1,183,783	52%
	2021	1,173,456	60%
	2022	1,527,643	64%
	2023	1,420,281	64%
	2024	**1,007,733**	**52%**
Mallra dhe shërbime	2019	316,339	14%
	2020	316,339	14%
	2021	400,000	20%
	2022	476,923	20%
	2023	476,923	22%
	2024	**476,923**	**25%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	50,000	2%
	2020	50,000	2%
	2021	50,000	3%
	2022	50,000	2%
	2023	50,000	2%
	2024	**50,000**	**3%**
Subvencione dhe grante	2019	100,000	4%
	2020	100,000	4%
	2021	100,000	5%
	2022	100,000	4%
	2023	100,000	5%
	2024	**185,000**	**10%**
Shpenzime kapitale	2019	600,000	27%
	2020	650,000	28%
	2021	240,000	12%
	2022	300,000	12%
	2023	150,000	7%
	2024	**200,000**	**10%**
Totali nga taksapaguesi	2019	2,250,122	**100%**
	2020	2,300,122	
	2021	1,963,456	
	2022	2,404,566	
	2023	2,197,204	
	2024	**1,919,656**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Gjilanit janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjilanit ndër vite




Në Universitetin e Gjilanit në vitin 2024, të ardhurat mesatare mujore ishte 1,730 EUR, ndërsa në vitin 2024 ajo ka qenë 1,546 EUR, duke reflektuar një ulje prej 184 EUR, apo rreth 11% më pak krahasuar me vitin e kaluar. Edhe shtesat mesatare mujore nga 546 EUR në 2023 në 455 EUR në 2024, një diferencë prej 91 EUR, ose rreth 17% më pak. Në raport me pagën bazë, shtesat përbënin rreth 32% të të ardhurave mujore në vitin 2023, ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje është ulur në rreth 29%.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjilanit


Në Universitetin e Gjilanit, ngritjen mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur Prodekanët, nga 1,404 EUR në vitin 2023, në 1,476 EUR në vitin 2024. Ndërsa uljen më të madhe mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 1,748 EUR në vitin 2023, në 1,326 EUR në vitin 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjilanit ndër vite



Në Universitetin e Gjilanit ngritje mesatare të shtesave kanë pasur Prodekanët, nga 389 EUR në vitin 2023, në 431 EUR në vitin 2024. Ndërsa uljen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 604 EUR në vitin 2023, në 288 EUR në vitin 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjilanit ndër vite



Universiteti i Prizrenit

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Prizrenit

Buxheti i Universitetit të Prizrenit në vitin 2024 ishte 2,966,621 EUR, i ndarë 64% në paga dhe mëditje, 20% në mallra dhe shërbime, 2% në shpenzime komunale, 6% në subvencione dhe grante dhe 7% në shpenzime kapitale.

98% i buxhetit të Universitetit të Prizrenit financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 2% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Prizrenit në vitin 2024 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 237 mijë e 461 EUR më pak në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	1,597,944	63%
	2020	1,545,728	62%
	2021	1,347,540	59%
	2022	2,070,728	66%
	2023	2,013,082	65%
	2024	**1,840,621**	**63%**
Mallra dhe shërbime	2019	600,000	23%
	2020	600,000	24%
	2021	600,000	26%
	2022	700,000	22%
	2023	600,000	19%
	2024	**600,000**	**21%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	73,000	3%
	2020	73,000	3%
	2021	73,000	3%
	2022	73,000	2%
	2023	73,000	2%
	2024	**73,000**	**3%**
Subvencione dhe grante	2019	100,000	3%
	2020	100,000	3%
	2021	100,000	4%
	2022	100,000	3%
	2023	100,000	3%
	2024	**185,000**	**6%**
Shpenzime kapitale	2019	200,000	8%
	2020	200,000	8%
	2021	180,000	8%
	2022	200,000	6%
	2023	350,000	11%
	2024	**200,000**	**7%**
Totali nga taksapaguesi	2019	2,570,944	**100%**
	2020	2,518,728	
	2021	2,300,540	
	2022	3,143,728	
	2023	3,136,082	
	2024	**2,898,621**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Prizrenit janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit ndër vite




Të dhënat për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë ndryshime më të vogla në të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Prizrenit. Në vitin 2023, të ardhurat mesatare mujore ishin 1,772 EUR, ndërsa në 2024 janë deklaruar 1,658 EUR, që paraqet një zbritje prej 114 EUR, ose rreth 6% më pak. Ndryshe nga të ardhurat mesatare mujore, shtesat mujore kanë shënuar një rritje nga 484 EUR në vitin 2023 në 579 EUR në vitin 2024, me një diferencë prej 95 EUR, që përfaqëson një rritje prej rreth 20%.

Në vitin 2023, shtesat përbënin rreth 27% të të ardhurave mujore, ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje është ngritur në rreth 35%.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prizrenit


Në Universitetin e Prizrenit ngritje mesatare të të ardhurave mujore kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 1,730 EUR në vitin 2023, në 1,771 EUR në vitin 2024. Ndërsa uljen më të madhe mesatare të të ardhurave mujore kanë pasur Prodekanët, nga 1,920 EUR në vitin 2023, në 1,547 EUR në vitin 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prizrenit ndër vite



Në Universitetin e Prizrenit ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e ka pasur Rektori me Prorektorë, nga 354 EUR në vitin 2023, në 625 EUR në vitin 2024. Ndërsa uljen mesatare të shtesave mujore e kanë pasur Prodekanët, nga 597 EUR në vitin 2023, në 478 EUR në vitin 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Prizrenit ndër vite



Universiteti i Gjakovës

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Gjakovës

Buxheti i Universitetit të Gjakovës në vitin 2024 ishte 3,309,059 EUR, i ndarë 38% në paga dhe mëditje, 14% në mallra dhe shërbime, 2% në shpenzime komunale, 6% në subvencione dhe grante dhe 41% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Gjakovës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Gjakovës në vitin 2024 ka pasur një ngritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 82 mijë e 210 EUR më shumë në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	1,184,828	50%
	2020	1,184,828	52%
	2021	1,181,477	55%
	2022	1,243,707	45%
	2023	1,223,126	38%
	2024	**1,220,336**	**37%**
Mallra dhe shërbime	2019	316,339	13%
	2020	316,339	14%
	2021	400,000	19%
	2022	476,923	17%
	2023	476,923	15%
	2024	**476,923**	**15%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	50,000	2%
	2020	50,000	2%
	2021	50,000	2%
	2022	50,000	2%
	2023	50,000	2%
	2024	**50,000**	**2%**
Subvencione dhe grante	2019	100,000	4%
	2020	100,000	4%
	2021	100,000	5%
	2022	100,000	4%
	2023	100,000	3%
	2024	**185,000**	**6%**
Shpenzime kapitale	2019	750,000	31%
	2020	650,000	28%
	2021	400,000	19%
	2022	900,000	32%
	2023	1,350,000	42%
	2024	**1,350,000**	**41%**
Totali nga taksapaguesi	2019	2,401,167	**100%**
	2020	2,301,167	
	2021	2,131,477	
	2022	2,770,630	
	2023	3,200,049	
	2024	**3,282,259**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Gjakovës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës ndër vite




Të dhënat për vitet 2023 dhe 2024 tregojnë ndryshime të konsiderueshme në përbërjen e të ardhurave mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Gjakovës. Të ardhurat mesatare mujore kanë shënuar një rënie nga 1,673 EUR në vitin 2023 në 1,558 EUR në vitin 2024, që përfaqëson një ulje prej 115 EUR, ose rreth 6.9%.

Në të kundërt, shtesat mujore kanë pësuar një rritje të ndjeshme nga 353 EUR në vitin 2023 në 516 EUR në vitin 2024. Kjo paraqet një rritje prej 163 EUR, ose afërsisht 46%.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjakovës


Në Universitetin e Gjakovës ngritje mesatare të të ardhurave mujore kanë pasur Rektori dhe Prorektorët, nga 1,504 EUR në vitin 2023, në 1,740 EUR në vitin 2024. Ndërsa uljen mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 2,040 EUR në vitin 2023, në 1,236 EUR në vitin 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjakovës ndër vite



Në Universitetin e Gjakovës ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur Rektori dhe Prorektorët, nga 139 EUR në vitin 2023, në 733 EUR në 2024. Ndërsa ulje mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 790 EUR në vitin 2023, në 267 EUR në 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Gjakovës ndër vite



Universiteti i Mitrovicës

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Mitrovicës

Buxheti i Universitetit të Mitrovicës në vitin 2024 ishte 3,567,551 EUR, i ndarë 65% në paga dhe mëditje, 15% në mallra dhe shërbime, 6% në shpenzime komunale, 5% në subvencione dhe grante dhe 9% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Mitrovicës financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Mitrovicës në vitin 2024 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 284 mijë e 908 EUR më pak në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	2,642,769	57%
	2020	2,765,045	68%
	2021	2,765,045	73%
	2022	2,879,706	70%
	2023	2,863,632	75%
	2024	**2,273,724**	**64%**
Mallra dhe shërbime	2019	866,339	19%
	2020	366,339	9%
	2021	450,000	12%
	2022	543,154	13%
	2023	543,154	14%
	2024	**543,154**	**15%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	215,000	5%
	2020	215,200	5%
	2021	215,200	6%
	2022	215,200	5%
	2023	215,200	6%
	2024	**215,200**	**6%**
Subvencione dhe grante	2019	100,000	2%
	2020	100,000	2%
	2021	100,000	3%
	2022	100,000	2%
	2023	100,000	3%
	2024	**185,000**	**5%**
Shpenzime kapitale	2019	850,000	17%
	2020	650,000	16%
	2021	240,000	6%
	2022	350,000	9%
	2023	100,000	3%
	2024	**320,000**	**9%**
Totali nga taksapaguesi	2019	4,674,308	**100%**
	2020	4,096,584	
	2021	3,770,245	
	2022	4,088,060	
	2023	3,821,986	
	2024	**3,537,078**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Mitrovicës janë përfshirë rektori, prorektorët, dekanët dhe prodekanët.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Mitrovicës ndër vite




Në Universitetin e Mitrovicës të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxheria kanë rënë nga 1,792 EUR në vitin 2023 në 1,538 EUR në vitin 2024, që paraqet një ulje prej 254 EUR, ose rreth 14.2%.

Shtesat mujore kanë shënuar gjithashtu një rënie, ndonëse më të lehtë nga 491 EUR në vitin 2023 në 455 EUR në vitin 2024. Kjo përfaqëson një diferencë prej 36 EUR, ose rreth 7.3% më pak.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës


Në Universitetin e Mitrovicës ngritje mesatare të të ardhurave mujore kanë pasur Rektori dhe Prorektorët, nga 1,588 EUR në vitin 2023, në 1,665 EUR në vitin 2024. Ndërsa uljen mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 2,019 EUR në vitin 2023, në 1,393 EUR në vitin 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës ndër vite



Në Universitetin e Mitrovicës ngritjen mesatare të shtesave e kanë pasur Rektori dhe Prorektorët, nga 181 EUR në vitin 2023, në 564 EUR në vitin 2024. Ndërsa ulje mesatare të shtesave mujore kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 787 EUR në vitin 2023, në 269 EUR në vitin 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Mitrovicës ndër vite



Universiteti i Ferizajt

Analiza e Shpenzimeve në Universitetin e Ferizajt

Buxheti i Universitetit të Ferizajt në vitin 2024 ishte 2,113,535 EUR, i ndarë 43% në paga dhe mëditje, 19% në mallra dhe shërbime, 1% në shpenzime komunale, 8% në subvencione dhe grante, dhe 28% në shpenzime kapitale.

99% i buxhetit të Universitetit të Ferizajt financohet nga taksapaguesi, ndërkaq vetëm 1% e gjeneron vet. Në tabelën e mëposhtme mund të shihen se si janë ndarë shpenzimet e financuara vetëm nga taksapaguesi përmes granteve qeveritare, sipas ligjeve për buxhete të viteve përkatëse.

Universiteti i Ferizajt në vitin 2024 ka pasur një zbritje të mbështetjes buxhetore nga qeveria, në vlerë prej 589 mijë e 816 EUR më pak në krahasim me vitin paraprak.


Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Paga dhe shtesa	2019	757,712	35%
	2020	757,712	44%
	2021	750,334	54%
	2022	927,712	50%
	2023	913,695	34%
	2024	**898,879**	**43%**
Mallra dhe shërbime	2019	210,696	10%
	2020	210,696	12%
	2021	232,326	16%
	2022	300,000	16%
	2023	400,000	15%
	2024	**400,000**	**19%**

Linja	Viti	Shuma në EUR	% në total të vitit
Shpenzime komunale	2019	21,000	1%
	2020	21,000	1%
	2021	21,000	1%
	2022	21,000	1%
	2023	21,000	1%
	2024	**21,000**	**1%**
Subvencione dhe grante	2019	56,500	3%
	2020	56,500	3%
	2021	56,500	4%
	2022	70,000	4%
	2023	100,000	4%
	2024	**175,000**	**8%**
Shpenzime kapitale	2019	1,150,000	51%
	2020	700,000	40%
	2021	350,000	25%
	2022	550,000	29%
	2023	1,250,000	46%
	2024	**600,000**	**29%**
Totali nga taksapaguesi	2019	2,195,908	**100%**
	2020	1,745,908	
	2021	1,410,160	
	2022	1,868,712	
	2023	2,684,695	
	2024	**2,094,879**	

Të ardhurat mesatare të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Ferizajt

Të ardhurat e stafit akademik përcaktohen sipas ligjit të pagave. Në analizën e deklaratave të pasurisë për Universitetin e Ferizajt janë përfshirë rektori, prorektorët dhe dekanët.

Të ardhurat mesatare mujore të stafit akademik menaxherial në Universitetin e Ferizajt ndër vite




Krahasimi i të dhënave për vitet 2023 dhe 2024 në Universitetin e Ferizajt tregon një ndryshim të dukshëm në strukturën e të ardhurave mujore të stafit akademik menaxherial. Të ardhurat mesatare mujore kanë rënë nga 1,846 EUR në vitin 2023 në 1,615 EUR në vitin 2024, që përfaqëson një ulje prej 231 EUR, ose rreth 12.5%.

Në të njëjtën kohë, shtesat mujore kanë shënuar një rritje, nga 591 EUR në 2023 në 609 EUR në vitin 2024 diferencë prej 18 EUR, ose rreth 3% më shumë.

Të ardhurat mujore përgjatë viteve sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Ferizajt


Në Universitetin e Ferizajt uljen më të madhe mesatare të të ardhurave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 1,580 EUR në vitin 2023, në 1,315 EUR në 2024.

Të ardhurat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Ferizajt ndër vite



Në Universitetin e Ferizajt ngritjen më të madhe mesatare të shtesave e kanë pasur Dekanët, nga 476 EUR në vitin 2023, në 579 EUR në 2024. Ndërsa ulje mesatare të shtesave mujore e kanë pasur anëtarët e Këshillit Drejtues që vijnë nga radhët e stafit akademik, nga 551 EUR në vitin 2023, në 350 EUR në vitin 2024.

Shtesat mesatare mujore sipas pozitave menaxheriale në Universitetin e Ferizajt ndër vite



Metodologjia

Objekt i hulumtimit ishin shtatë universitetet publike dhe stafi akademik menaxherial i tyre që përfshijnë rektorët, prorektorët, dekanët, prodekanët dhe anëtarët e këshilleve drejtuese me tituj akademikë. Raporti paraqet gjetje të bazuara në hulumtimin e të dhënave të vitit 2024.

Për krahasime me vitet e kaluara janë marrë për bazë raportet 'Transparenca Financiare e Universiteteve Publike 2023' Dhe '3 Vite Hulumtim dhe Monitorim i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Kosovë', të publikuara nga ORCA.

Hulumtimi i shpenzimeve të universiteteve publike

Janë hulumtuar shpenzimet e shtatë universiteteve publike duke u bazuar në Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2024 (LIGJI NR. 08/L-260). Nga ky ligj janë marrë shpenzimet e alokuara për vitin 2024 përfshirë grantet qeveritare dhe të hyrat vetanake të universiteteve publike të Kosovës.

Hulumtimi i shpenzimeve të universiteteve publike

Gjatë muajit qershor 2025 është bërë mbledhja e të dhënave nga deklarimet e pasurisë që anëtarët e stafit akademik menaxherial i kanë bërë në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për të hyrat e tyre në vitin 2024. Analiza e të hyrave të stafit akademik ka për qëllim të identifikojë se në çfarë vlere përmbi pagën bazë paguhet stafi akademik nga universitetet publike.

Nga totali i të ardhurave të deklaruara, pagat bazë janë llogaritur sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik (08/L-196). Shtesat janë klasifikuar në dy kategori: Shtesat funksionale, të cilat lidhen me pozitat menaxheriale dhe shtesat e tjera, që përfshijnë kompensime për orë shtesë, angazhime në komisione, monitorim diplomash etj.

Shtesat funksionale janë kalkuluar bazuar në rregullativat në fuqi dhe përfaqësojnë një përqindje shtesë mbi pagën bazë që u takon stafit menaxherial sipas titullit akademik, siç përcaktohet në Ligjin për Pagat në Sektorin Publik. Përkatësisht:

- Rektorët: 20%
- Prorektorët: 18%
- Dekanët: 15%
- Prodekanët: 13%

Për anëtarët e Këshillave Drejtuese, shtesa funksionale është 20% e pagës bazë të Zyrtarit më të Lartë Administrativ që në rastin e universitetit është Sekretari i Përgjithshëm.

Në rastet kur në deklaratat e pasurisë mungon specifikimi i shtesave të tjera, ato janë llogaritur si diferencë ndërmjet të ardhurave totale të deklaruara dhe shumës së pagës bazë së bashku me shtesën funksionale.

Kompensimet për angazhime të tjera jashtë detyrave të rregullta profesionale (si pjesëmarrja në projekte, mëditje për udhëtime, subvencione për publikime apo konferenca) nuk janë përfshirë në këtë analizë.

Ligji për pagat

Në janar të vitit 2023 ka hyrë në fuqi Ligji për Pagat në Sektorin Publik 08/L-196, i cili rregullon nivelin e kompensimit të pozitave që paguhen nga buxheti i Kosovës. Ligji ka përcaktuar koeficientët, mbi të cilët kalkulohet paga varësisht nga vlera e koeficientit, që në vitin 2024 ka qenë 110 EUR. Në figurën e mëposhtme mund të shihen kompensimet sipas pozitave akademike dhe drejtuese në arsim të lartë në Kosovë.

SHTOJCA NR.8 - NËPUNËSI PUBLIK I ARSIMIT UNIVERSITAR DHE PARAUNIVERSITAR					
NR.	**EMËRTIMI I POZITËS**	**GRUPI**	**KLASA**	**KOEFICINETI**	**FUSHA E ZBATIMIT**
1	Rektor		E1	14.2	
2	Pro - Rektor		E2	13	Në rast se nuk pezullohet puna si staf akademik, aplikohet shtesa funksionale e përcaktuar në nenin 32 të Ligjit
3	Dekan		E3	12.8	
4	Pro - Dekan		E4	12.6	
5	Profesor i rregullt		E5	12.4	
6	Profesor i asocuar		E6	11.4	
7	Profesor asistent		E7	10.4	
8	Ligjërues		E8	8.6	
9	Lektor/korepetitor		E9	7.5	
10	Asistent /Hulumtues i Pavarur		E10	7.2	
11	Asistent i ri / Hulumtues		E11	6.6	
12	Laboranti në Universitet		E12	6.4	

Sipas ligjit, profesorët që mbajnë ligjërata dhe angazhohen në një pozitë drejtuese në fakultet ose universitet mund të marrin si shtesë funksionale kompensim deri në 20% mbi pagën bazë.

“Profesoret/ët universitare/ë, në rastet kur kryejnë edhe funksionet si rektor/e, prorektor/e, dekan/e, prodekan/e dhe shef/e e/i departamentit, përfitojnë shtesë funksionale për ushtrimin e funksionit përkatës. Vlera e shtesës nuk mund të kalojë njëzet për qind (20%) të pagës bazë të profesores/it universitar/e.”

Stafi akademik i cili ka pasur kontratë valide para se të hyj ligji në fuqi ka përfituar kompensim sipas dispozitës kalimtare të ligjit, që do të thotë nuk do të ketë zbritje të pagës. Ndërkaq ata që kanë nënshkruar kontratë të re pas hyrjes në fuqi të ligjit, kanë pasur kompensim sipas koeficientëve të caktuar në ligj.

Koeficienti në vitin 2023 e ka pasur vlerën 105 EUR ndërsa në vitin 2024 koeficienti ka pasur vlerën 110 EUR.

Kufizimet metodologjike

Ligji për paga ka hyrë në fuqi në kohën kur disa nga kontratat e stafit menaxherial akademik kanë qenë aktive me bazë rregullative të vjetër. Meqenëse është e pamundur të verifikohet secila kontratë se kur është nënshkruar, atëherë ky hulumtim për bazë e ka marrë vetëm ligjin e ri të pagave dhe jo rregullativat e vjetra, tek të cilat kompensimi mund të ketë qenë ndryshe.

Në varësi prej viteve të përvojës së punës stafi akademik ka të drejtë në shtesa, dhe meqenëse për ta identifikuar këtë shtesë do të duhet të shikohet secila kontratë veçmas, atëherë ky hulumtim është bazuar vetëm mbi koeficientet bazë sipas ligjit të pagave.

Deklaratë e mohimit të përgjegjësisë:

Ky dokument është përpiluar me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura këtu në asnjë mënyrë nuk mund ta pasqyrojnë mendimin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim.

With funding from

Austrian Development Cooperation

Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku, Tehnologiju i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

KEC
Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center

ORCA
organizata për mitjen e cilësisë në arsim